

Pensionistët u prezantuan me këngë të bukura maqedonase dhe shqipe të shoqëruara me instrumente burimore

REVYJA E 10-TË JUBILARE FOLKLORIKE E KËNGËVE, MUZIKËS DHE VALLEVE

Edhe këtë vit, përkundër pandemisë u mbajtën revytë folklorike në vendin tonë. Në Revytë e 18-ta rajonale të këngëve, muzikës dhe valleve morën pjesë 39 shoqata nga shtatë rajonet. Nikoqirë ishin shoqatat e pensionistëve Lozovë, Makedonska Kamenicë, Veles, Demir Hisar dhe shoqatat e Shkupit Saraj, Çair dhe Karposh, të cilat u mbajtën në Qendrën sportive rekreative Saraj.

Të gjitha shoqatat, të cilat ishin nikoqire, kanë kryer detyrën e dhënë me sukses dhe me përgjegjësi. Revytë u mbajtën në ambient të hapur sipas të gjitha protokolleve dhe sipas rekomandimeve të LSHPM, për çka të gjithë duhet të jemi krenarë, e posaçërisht shoqatat e pensionistëve që ishin nikoqire. Me këto revy nuk u bë devalvimi i revyve edhe përkundër kushteve specifike nga Kovid 19, por përkundrazi, pensionistët edhe njëherë treguan se kanë edhe energji edhe mençuri për të kapërcyer të gjitha pengesat dhe problemet dhe nga secili



rast të nxjerrin përvojë për në të ardhmen.

Pas përfundimit të revyve rajonale folklorike të këngëve, muzikës

dhe valleve u mbajt Revyja e 10-të jubilarë folklorike më 15 tetor të këtij viti në Shkup, në restorantin "Ritual" në sallën e hapur. Në fil-

lim, të pranishmit i përshëndeti kryetarja e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Stanka Trajkova.

Pastaj filloi revyja. Pensionistët këndonin, luanin në instrumente dhe recitonin me zemër dhe dashuri para skenës së rregulluar bukur, e cila edhe këtë vit ishte vepër e vullnetarëve të palodhshëm të pensionistëve.

Edhe këtë herë pensionistët u prezantuan me këngë të bukura maqedonase dhe shqipe të përcjella me instrumente burimore, shumica të veshur me veshje të bukura popullore nga rajonet e tyre. Muzikën dhe këngët i shijuan edhe realizuesit edhe publiku, edhe të parët edhe të dytët me numër të reduktuar sipas rekomandimeve të gjithë realizuesit u përshëndetën me duartrokitje të fuqishme nga të pranishmit. E vetmja gjë që mungonte ishte se nuk morën pjesë më shumë shoqata sepse edhe shoqatat tjera me kualitetin e tyre e meritojnë, por marrëveshja dhe rekomandimet u respektuan nga fillimi deri në fund. Në fund, kryetari i Kuvendit të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, M-r. Ilija Adamoski i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për evenimentin e bukur dhe kryetarët e shoqatave. (K.S.A)

Shtëpitë private të pleqve të shtrenjta për pensionistët me të ardhura të ulëta

Më 12 nëntor të këtij viti, Këshilli ekzekutiv i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë ka mbajtur seancën e vet të katërmëdhjetë. Me seancën në mënyrë të suksesshme ka udhëhequr kryetarja e Lidhjes, Stanka Trajkova. Si zakonisht, në fillim të seancës kryetarja Trajkova ka njoftuar të pranishmit me aktivitetet më të rëndësishme gjatë periudhës së kaluar.

"Edhe gjatë periudhës së kaluar edhe krahas pandemisë, jemi munduar që vazhdimësia e punës së organeve dhe trupave të Lidhjes të mos jetë i ndërprerë. Gjatë kësaj periudhe është përgatitur Informacion cilësor me të dhënat, të cilat kanë sjellë anëtarët e Komisionit për shtëpitë e pleqve dhe standardin e pensionistëve, për gjendjet dhe funksionimin e shtëpive në vendin tonë. Siç theksojmë vite me radhë vendosja institucionale, por edhe jashtë institucionale, e anëtarëve tanë janë prioritetet e para të Lidhjes, sepse numri i kërkuesve priritet, dhe për momentin nuk ka shtëpi të reja shtetërore, ndërsa ato private janë shumë të shtrenjta për pensionistët me të ardhura të ulëta", tha Trajkova, ndërsa shtoi se tashmë janë ngritur edhe disa iniciativa të dobishme deri te institucio-

net, të cilat merren me problematikën e pensionistëve, për përmirësimin e jetës së pensionistëve, posaçërisht në domenin e mbrojtjes shëndetësore.

"Në vazhdim është edhe përpilimi i një Doracaku për punë me kompjuter dhe internet. Po përpilohet një Doracak për punë me kompjuter dhe internet për të rriturit, sepse nxënja informatike për të gjithë, si dhe për të popullatën e moshuar është e domosdoshme, posaçërisht në këto ditë të vështira pandemie kur i tërë komunikimi në të gjitha nivelet është përmes telefonit, kompjuterit dhe internetit. Doracaku përpilohet me mjete nga Banka komerciale me rialokimin e fondeve që na ishin premtuar për evenimente sportive, të cilat siç edhe jeni të informuar, nuk janë mbajtur këtë vit për shkak të pandemisë. Kemi konkuruar në Konkursin vjetor të Ministrisë së Kulturës për vitin 2021 në programin për mbështetje të projekteve me interes nacional nga fusha e kulturës në vendin tonë, sepse është e ditur që pensionistët janë mbrojtësit e besueshëm të pasurisë kulturore të të gjithëve që jetojnë në këto hapësira", informoi ajo. Pas fjalimit të Trajkovës, seanca filloi të punojë sipas rendit të

aprovuar të ditës. Fillimisht u shqyrtua, dhe më pastaj u miratua Raporti financiar për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2020 të Lidhjes, së bashku me Reportin e Këshillit mbikëqyrës. Reportin e shpjegoi sekretari i KE të LSHPM, Menka Temellkovska, e cila tha se edhe krahas pandemisë dhe shpenzimeve të caktuara të jashtëzakonshme, çdo gjë po bëhet në suaza të asaj që është planifikuar. Informacionin mbi gjendjen dhe funksionimin e shtëpive të pleqve dhe pensionistëve e elaboroi Dr. Snezhana Makrevska, anëtare e Komisionit për shtëpitë e pleqve dhe standardin e pensionistëve. Ajo theksoi vetëm të dhënat më të rëndësishme dhe tha se informacioni është përpiluar për qëllim që të shihen mundësitë në dispozicion të akomodimit të përdoruesve të pensionit. "Është bërë kontrollimi i kapaciteteve shtetërore dhe private në dispozicion për akomodimin e personave të moshuar dhe janë grumbulluar të dhëna për atë se kush menaxhon me shtëpitë, të dhëna për kushtet e banimit dhe pranimin në shtëpi, numrin e shtretërve, çmimet për akomodim, ushqim, mbrojtje shëndetësore etj", tha Makrevska. Në bazë të

informatave të fituara, Shërbimi profesional i Lidhjes përpiloi Informacion integral me të dhëna relevante dhe cilësore. "Në vendin tonë, sipas asaj se kush menaxhon me shtëpitë, ekzistojnë institucione publike nën kompetencat e Qeverisë, institucione publike me të cilat menaxhon Vetëqeverisja lokale, institucione publike private për kujdesje sociale të të moshuarve sipas mendimit paraprak të MPPS, dhe institucione për mbrojtje sociale nën menaxhim të Ministrisë së shëndetësisë.

"Numri i shtretërve nuk është i mjaftueshëm, ndërsa çmimet në shtëpitë shtetërore u përshtaten të ardhurave të pensionistëve, por janë të larta në ato private, të cilat në vendin tonë janë gjithsej 27 dhe posedojnë 480 shtretër.

Në shtëpitë private të pleqve çmimet sillen prej 24 deri në 40 mijë denarë, dhe janë më të larta se në Serbi, ku çmimet janë prej 300 deri në 450 euro. Në fund u miratuan konkluzionet me disa plotësim dhe rekomandim që informacioni të dorëzohet deri te MPPS dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut", tha Shërbimi profesional i Lidhjes. Në ndërkohë, Reportin nga Revyja rajonale dhe ajo 10-të Jubilarë Folklorike republikane e

këngëve, muzikës dhe valleve në vitin 2020 e prezantoi Tomçe Stojkov, përzgjedhës i Revysë së 18-të rajonale të këngëve, muzikës dhe valleve dhe regjisor i Revysë së 10-të jubilarë folklorike - Shkup 2020. Në seancë për miratim u parashtrua edhe Propozimi për marrjen e statusit me interes publik të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë.

Dr. Fidanço Stoev, kryetar i forumit privat-ekonomik, shpjegoi iniciativën dhe mes tjerash tha se rruga deri në realizimin e kësaj iniciative do të jetë e vështirë, sepse për momentin vetëm 3 shoqata kanë fituar statusin e këtyllë, por nëse e marrim, përfitim do të kemi të gjithë, edhe Lidhja edhe shoqatat anëtare të saj. Dobia do të jetë e shumanshme. Pastaj, para të pranishmëve u propozua në emër të Këshillit ekzekutiv deri te Këshilli për etikë në media të Maqedonisë dhe Këshilli i nderit pranë SHGM-së, të parashtrohet ankesë kundër kolumnave të Mendo Dimovski, i cili për një kohë të gjatë i boton dhe shqetëson pensionistët duke dhënë mendimet dhe supozimet e tij pa ofruar argumente dhe fakte! Në seancë janë sjellë edhe disa vendime të rëndësishme për punën e Lidhjes.